

**KOMISIONI EVROPIAN
KUNDËR RACIZMIT DHE INTOLERANCËS**

**REKOMANDIM N° 4 PËR POLITIKËN
E PËRGJITHSHME I ECRI-T:**

**VËZHGIME KOMBËTARE MBI PËRVOJËN
DHE PERCEPTIMIN E DISKRIMINIMIT
DHE RACIZMIT NGA PIKËPAMJA
E VIKTIMAVE TË MUNDSHME**

MIRATUAR MË 6 MARS 1998

Strasbourg, 1998



COUNCIL OF EUROPE
CONSEIL DE L'EUROPE

Secretariat of ECRI
Directorate General of Human Rights and Legal Affairs
Council of Europe
F - 67075 STRASBOURG Cedex
Tel.: +33 (0) 3 88 41 29 64
Fax: +33 (0) 3 88 41 39 87
E-mail: combat.racism@coe.int

Vizitoni ueb-saitin tonë: www.coe.int/ecri

Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës:

Duke kujtuar Deklaratën e miratuar nga Kryetarët e Shteteve dhe të Qeverive të Shteteve anëtare të Këshillit të Evropës në Takimin e Nivelit të Lartë mbajtur në Vienë më 8-9 tetor 1993;

Duke kujtuar që Plani i Veprimit mbi luftimin e racizmit, ksenofobisë, antisemitizmit dhe intolerancës i parashtruar si pjesë e kësaj Deklarate ftonte Komitetin e Ministrave që të krijonte Komisionin Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës me një mandat, ndër të tjera, që të formulonte rekomandime të politikës së përgjithshme për Shtetet anëtare:

Duke kujtuar gjithashtu Deklaratën Përfundimtare të miratuar nga Kryetarët e Shteteve dhe të Qeverive të Shteteve anëtare të Këshillit të Evropës në Takimin e tyre të dytë të Nivelit të Lartë mbajtur në Strasburg më 10-11 tetor 1997;

Duke theksuar që kjo Deklaratë Përfundimtare konfirmon që qëllimi i Shteteve anëtare të Këshillit të Evropës është të ndërtojë një shoqëri evropiane më të lirë, më tolerante dhe më të drejtë dhe që ai bën thirrje për intensifikimin e luftës kundër racizmit, ksenofobisë, antisemitizmit dhe intolerancës;

Duke kujtuar që në Rekomandimin N° 1 për politikën e përgjithëshme ECRI u bënte thirrje Shteteve të mbledhin, në përputhje me ligjet, rregulloret dhe rekomandimet evropiane mbi mbrojtjen e të dhënave dhe jetës private, ku dhe kur të jetë e përshtatëshme, të dhëna të cilat do të ndihmojnë në vlerësimin e situatës dhe përvojave të grupeve të cilat janë

veçanërisht vulnerabël ndaj racizmit, ksenofobisë, antisemitizmit dhe intolerancës;

Duke theksuar që të dhënat statistikore mbi veprimet raciste dhe diskriminuese dhe mbi situatën e grupeve të pakicave në të gjitha fushat e jetës janë jetike për njehsimin e problemeve dhe formulimin e politikave;

Të bindur që këto të dhëna statistikore duhet të plotësohen me të dhëna mbi qëndrimet, opinionet dhe perceptimet;

Duke konsideruar në këtë drejtim që, krahas vëzhgimeve për popullsinë në përgjithësi, vëzhgime me shënjestër, që të vërtetojnë përvojat dhe perceptimet e viktimave të mundshme lidhur me racizmin dhe diskriminimin që ata përballojnë, përfaqësojnë një burim novator dhe të vlefshëm informacioni;

Duke konsideruar që rezultatet e këtyre vëzhgimeve mund të përdoren në një sërë mënyrash për të nxjerrë në pah problemet dhe për të përmirësuar situatën;

Duke konsideruar për më tepër që njohja e vlefshmërisë përvojave dhe perceptimeve të viktimave të mundshme u jep një mesazh të rëndësishëm si popullsisë në tërësi ashtu edhe vetë grupeve vulnerabël;

Duke mirëpritur faktin që këto vëzhgime janë organizuar tashmë në një numër Shtetesh anëtare;

Duke vënë re që organizimi i vëzhgimeve të tilla kudo nëpër Europë do të japë një imazh më të detajuar të situatës lidhur me racizmin dhe diskriminimin si në rrafsh kombëtar ashtu edhe në atë evropian:

u rekomandon qeverive të Shteteve anëtare të marrin masa për të siguruar që të organizohen vëzhgime kombëtare mbi përvojat dhe perceptimet e racizmit dhe diskriminimit nga pikëpamja e viktimave të mundshme, duke u frymëzuar nga direktivat e parashtruara në Shtojcën e këtij rekomandimi.

Shtojcë në rekomandimin N° 4 të ECRI-t për politikën e përgjithshme

Direktiva për organizimin e vëzhgimeve mbi përvojën dhe perceptimin e racizmit dhe diskriminimit nga pikëpamja e viktimave të mundshme

I. Qëllime të përgjithshme të vëzhgimeve të tilla

1. Qëllimi i tipit të vëzhgimit të skicuar në këtë rekomandim është të përftojë një imazh të problemeve të racizmit dhe intolerancës nga pikëpamja e viktimave faktike dhe të mundshme. Kjo përjasje novatore përfshin kryerjen e një vëzhgimi ndër anëtarët e grupeve të ndryshme vulnerabël ndaj akteve të racizmit, ksenofobisë, antisemitizmit, dhe intolerancës, me pyetje që synojnë të nxjerrin informacion rreth përvojave të tyre të racizmit dhe diskriminimit dhe se si perceptojnë ata aspekte të ndryshme të shoqërisë në të cilën jetojnë, në këtë drejtim. Të dhënat e mbledhura kështu kanë të bëjë me perceptimet dhe përvojat e anëtarëve të grupeve vulnerabël. Të dhëna të tilla mund të plotësojnë dhe pasurojnë të dhëna më sasiore lidhur me incidentet raciste dhe nivelet e diskriminimit në fusha të ndryshme dhe të dhëna lidhur me opinionet dhe qëndrimet e shumicës së popullsisë ndaj grupeve të pakicës dhe çështjeve të racizmit dhe intolerancës.

II. Organizimi praktik i vëzhgimeve

2. Hartimi dhe zbatimi i këtyre vëzhgimeve mund t'u besohet kërkuesve ose instituteve me përvojë në fushën e racizmit dhe intolerancës, me punën në terren të kryer nga organet kërkimore vëzhguese.
3. Grupet e pakicës të zgjedhura si "kategori" për vëzhgimin do të varen në përputhje me rrethanat kombëtare, dhe mund të përfshijnë për shembull grupet e imigrantëve, pakicat kombëtare dhe/ose grupe të tjera vulnerabël.
4. Kur zgjidhet se cilat grupe do të përfshihen si "kategori", faktorët që do të merren në konsideratë mund të përfshijnë përmasat e popullsisë në shënjestër dhe informacion tashmë në dispozicion lidhur me shkallët e diskriminimit të përbulluar nga secili grup (për shembull, statistikat e punësisimit, informacion mbi ankimet për diskriminim të regjistruara).
5. Përfshirja e grupeve të "kontrollit" ose "kontrastit" mund të jetë e përshtatshme që të ofrojë një vijë bazë krahasimi: për shembull, mund të përfshihet në vëzhgim një grup pakice që përgjithësisht nuk duket se përballet me probleme të mëdha diskriminimi dhe racizmi.
6. Statistika të mira popullore, duke përfshirë informacion për faktorë të tillë të ndryshueshëm si vendi i lindjes, origjina etnike, përkatësia fetare, gjuha amtare, shtetësia etj., lehtësojnë organizimin e vëzhgimeve të tilla. Në se ky lloj të dhënash popullore nuk gjendet, duhet të gjenden mjete alternative për njehsimin dhe arritjen te personat që mbrohen.
7. Duhet të mbahet parasysh se disa grupe që mund të jenë veçanërisht në rrezik lidhur me racizmin dhe diskriminimin - për shembull, imigrantët ilegalë - mund të jetë shumë e vështirë të arrihen me vëzhgime të tilla.

III. Hartimi i vëzhgimit

8. Përveç çështjeve lidhur me kontekstin social-ekonomik dhe hollësi të tjera faktike, pyetjet e vëzhgimit mund të futen në kategoritë e gjera si më poshtë:
- pyetje lidhur me situata konkrete, të tilla si kontaktet me autoritete të ndryshme (p.sh. policia, kujdesi shëndetësor, institucionet arsimore) si edhe me institucione të tjera (p.sh. bankat, agjensitë e strehimit) dhe me struktura (p.sh. punëdhënës, restorante, vende argëtimi, dyqane): pyetjet mund të bëhen lidhur me sa herë brenda një periudhe të caktuar (p.sh. vitin e kaluar ose gjatë pesë vjetëve të fundit) personat që mbrohen kanë qenë viktima të trajtimit të padrejtë për shkak të anëtarësisë së tyre në një grup pakice dhe çfarë trajtimi të padrejtë kanë përjetuar ata.
 - pyetje lidhur me oportunitetet e perceptuara për të marrë pjesë në kushte të barazisë në shoqëri, ndërgjegjësimin për masa specifike të marra për të përmirësuar situatën e grupeve të pakicës dhe masën në të cilën janë realizuar oportunitete të tilla (fushat e mbuluara të përfshijnë për shembull mundësitë për sukses në arsim dhe trainim profesional, mundësitë për punësim).
 - pyetje lidhur me perceptime dhe qëndrime: temat e mbuluara mund të përfshijnë, sipas përshtatshmërisë: masën e besimit të institucionet, qëndrimet ndaj politikave të imigrimit ose pakicave, vlerësimet e vendit si vend racist ose ksenofobik, probleme lidhur me fenë, qëndrime ndaj grupeve të tjera, vështirësi për të vendosur kontakte me popullsinë e shumicës, njehsimin me vendin pritës dhe vendin e origjinës, planet për të qëndruar ose për t'u kthyer, ku ndjehen njerëzit "në shtëpi", etj. Futja e temave të tilla bën të mundur të zbulohen marrëdhënie interesante ndërmjet shkallës së diskriminimit të përjetuar dhe qëndrimet dhe perceptimet e mundshme.
9. Duhet vënë në dukje se pyetje të tilla gjenerojnë kryesisht të dhëna mbi *përvojat subjektive* të diskriminimit. Sidoqoftë, është në çdo rast jashtëzakonisht e vështirë që aktet e diskriminimit të studjohen objektivisht dhe "në ngjarje" meqenëse ato ndodhin në situata të ndryshme të jetës. Raportet mbi diskriminimet e përjetuara subjektivisht janë të vlefshme si një tregues, veçanërisht kur ato vlerësohen përkundrejt një konteksti informacionesh të tjera, p.sh. statistika papunësie, evidenca policie, ankime të regjistruara etj.

IV. Vëzhgime ndjekëse

10. Pas një periudhe kohe mund të bëhen vëzhgime ndjekëse për të parë ndryshimin në kohë të formave të diskriminimit dhe racizmit ose për të përfshirë grupe të ndryshme.
11. Rezultatet e vëzhgimit mund të përdoren në shumë mënyra të ndryshme, për shembull: të nxjerrin në pah fushat ku është veçanërisht i nevojshëm veprimi; për vlerësimin dhe përpunimin e politikave që marrin parasysh përvojat dhe shqetësimet e diskriminimit të para nga pikëpamja e viktimave; për të rritur ndërgjegjësimin ndër ata që punojnë në zona të veçanta se si institucionet dhe praktikrat e tyre perceptohen nga grupet e pakicës (p.sh. policia, punëdhënësit, ofruesit e shërbimeve etj.).

